



Procesverbal i Dëgjimeve për Buxhetin e vitit 2022 dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2022-2024 *në:* **Malësi të Vogël**

		REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO			
		KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC			
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES/KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET					
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)					
Nr./Br./No		856		Nr. i faq/Br str/No.pg 250	
Data/Datum/Date		12/8/21			
RAHOVEC / ORAHOVAC					

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2022 dhe KAB-in për vitet 2022-2024, u publikua me datë: 17.06.2021 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në të dy gjuhët, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/06/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-Buxhetin-e-vitit-2022-dhe-Korniza-Afatmesme-Buxhetore-KAB-te-Komunes-se-Rahovecit-per-vitet-2022-2024.pdf> dhe <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/06/Raspored-Javni-Rasprava-za-Budzet-i-Srednjorocni-Okvir-Budzeta-Opstine-Orahovac-za-2022-2024.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, nenit 6 pika 1.3, i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publike në Komuna, Rregullores Komunale për Transparencë me Nr. Prot. 2697, njoftojmë se nga data: 06.07.2021 deri me datë: 16.07.2021 nën organizimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) do të organizohen pesëmbëdhjetë (15) dëgjime publike buxhetore me qytetarë, për planifikimin e buxhetit për vitin 2022 dhe KAB-in për vitet 2022-2024.

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendari i dëgjimeve buxhetore për pesëmbëdhjetë (15) dëgjimet buxhetore në vendbanimet e komunës së Rahovecit në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/06/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-per-Buxhetin-e-vitit-2022-dhe-Korniza-Afatmesme-Buxhetore-KAB-te-Komunes-se-Rahovecit-per-vitet-2022-2024.pdf> më datë: 17.06.2021.

Poashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar me kohë banorët e secilit vendbanim rreth mbajtjes së dëgjimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilin vendbanim, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit në atë vendbanim.

Njoftimi për mbajtjen e dëgjimit buxhetor në fshatin Malësi e Vogël dhe Gexhë u publikua më datë: 29.06.2021 në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2021/06/Njoftim-per-degjim-publik-per-buxhetin-e-vitit-2022-dhe-KAB-in-2022-2024-me-banor-te-fshatrave-Malesi-e-Vogel-Gexhe-Ratkoc-Dejne-Vrajak-dhe-Bratotin.pdf>

Njoftimet përveç që janë publikuar në uebfaqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social Facebook, njoftimet u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale Viber dhe WhatsApp.

DËGJIMI PUBLIK NË MALËSI TË VOGËL

Dëgjimi i parë publik buxhetor u mbajt më datë: **06.07.2021**, në orën **19:00**, me banorët e fshatit **Malësi e Vogël** dhe **Gexhë**, në objektin e SHFMU “Skender Kastrati” në **Malësi të Vogël**.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë dëgjim nga KPF-ja dhe zyrtarë komunal ishin: 11

- Femra ishin 4
- Meshkuj ishin 7

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 13

- Femra ishin 0
- Meshkuj ishin 13

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë dëgjim.

Dëgjimi publik filloi në orën: 19:10.

Dëgjimin e shpalli të hapur kryesuesi i Kuvendit Komunal, z.Afrim Dina.

Afrim Dina: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuar kryetar i fshatit Malësi e Vogël, i nderuar përfaqësues nga këshilli i fshatit Gexhë, të nderuar anëtarë të KPF-së, i nderuar drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Afrim Limani, të nderuar të pranishëm. Faleminderit që keni gjetur kohë të vini. Jemi sot këtu për të filluar dëgjimet buxhetore, dëgjime këto që mbahen vit për vit, për të marrë kërkesat tuaja si banorë, prioritetet që ju keni dhe më pas t’i harmonizojmë në planifikimin që bëhet për vitin 2022. Ne jemi munduar vit pas viti që ato nevojat që keni pasur si qytetarë, ato prioritetet që ju e keni vlerësuar që janë më kryesore dhe që edhe me shkrim i keni adresuar në Komunë t’i përmbushim, por, se e di që aty nuk përfundon asgjë, sepse ka akoma për tu bërë.

Të nderuar ju e dini që peshën dhe përgjegjësinë e buxhetit e ka drejtori i financave, të cilin e ftoj që të na paraqes në pika të shkurtëra ndarjet buxhetore.

Afrim Limani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, faleminderit për pjesëmarrje!

Ju tashmë e dini dhe është fakt i pamohueshëm, që në vendin tuaj janë bërë disa punë shumë të mira edhe të tjera pritet të bëhen, varësisht prej kërkesave tuaja dhe mundësive buxhetore, Buxheti për vitin 2022 do të jetë 15,053,660.00 Euro.

Buxheti ndahet në disa kategori si:

• Pagat dhe Mëditjet	7.811.508.00
• Mallrat dhe Shërbimet	1.690.005.00
• Shpenzimet Komunale	270.000.00
• Subvencionet dhe Transferet	360.000.00
• Shpenzimet Kapitale	4.922.147.00
TOTAL:	15.053.660.00

Ajo që juve ju intereson më së shumti janë Investimet Kapitale, të cilat këtë vit pritet të jenë mbi 600,000 euro më shumë se këtë vit. Por, prapë është shumë e vogël në krahasim me nevojat që ka komuna e Rahovecit.

Enver Qadraku- (*kryetar i këshillit të fshatit Gexhë*): Sa mblidhen të hyrat nga tatimi në pronë, drejtor?

Afrim Limani: I nderuar, 1,300,000.00 euro mblidhen vetëm nga të hyrat vetanake, pjesa e taksave me rastin e nxjerrjes së një dokumenti, 50 % e të hyrave nga tatimi në pronë shfrytëzohen në Investimet Kapitale, shpërndahen nëpër projekte të ndryshme, kështu që bëni mirë që sa më shumë të paguani tatimin në pronë, sepse, kështu direkt investoni në të ardhmen tuaj.

Enver Qadraku (*kryetar i këshillit të fshatit Malësi e Vogël*): Përshëndetje për të gjithë! Unë si përfaqësues i fshatit Malësi e Vogël, do t'i paraqes disa nga kërkesat që kemi si fshat, e që jemi dakorduar t'i paraqesim si prioritet pas mbledhjes së mbajtur me kryesinë e fshatit. Një falënderim kam për drejtorin e Arsimit, falë të cilit i kemi disa projekte të realizuara në fshat.

Kërkesat e fshatit **Malësi e Vogël** janë:

- Rregullimi i përrojeve (Biçec, i Gexhës)
- Rregullimi i kanalizimeve në disa lagje të fshatit
- Vazhdimi i kubëzimit të rrugëve
- Ndërtimi i miniparqeve
- Ndërtimi i trotuareve në drejtim të fshatit Gexhë
- Uji i pijes te rruga Avni Shabani
- Rregullimi i rrugëve fushore
- Furnizim me shporta të mbeturinave përgjatë rrugës kryesore
- Ndriçimi i rrugës "Shkolla Shqipe"

Skender Zena-Malësi e Vogël: të nderuar të pranishëm, desha me shpreh shqetësimin tim rreth disa përrojeve të cilat janë në gjendje shumë të keqe e që të gjithë jemi të kërcënuar nga ta.

Zymer Himaj (*përfaqësues i fshatit Gexhë*)- Së pari ju falënderoj në emër të këshillit të fshatit Gexhë!

Kërkesat e fshatit **Gexhë** janë:

- Rregullimi i qendrës së fshatit Gexhë
- Rregullimi i kanalizimit
- Ndërtimi i trotuareve Gexhë-Malësi e Vogël
- Ndërtimi i rrugëve fushore dhe malore
- Kubëzimi i rrugëve

Nexhmedin Krasniqi-Gexhë: Të nderuar, pasi që kërkesat veç i paraqiti parafolësi, unë veç dua të ju falënderoj për punën e mirë që keni bërë.

Afrim Dina: Të nderuar të pranishëm, faleminderit që u bëtë pjesë e këtyre dëgjimeve buxhetore dhe direkt pastaj jeni edhe pjesë e investimeve dhe projekteve që do të bëhen. Unë e di që disa prioritetë edhe janë përsëritur edhe nga viti i kaluar, por, nuk kanë arritur të përfundohen.

Ne do t'i trajtojmë me kujdes kërkesat dhe prioritetet tuaja, ne i morëm shënimet, por, luteni që kërkesat tuaja t'i adresoni edhe me shkrim në Komunën e Rahovecit.

Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje!

Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatit Malësi e Vogël dhe Gexhë përfundoi në orën: 19:45.

Blerta Gashi

*Zyrtare përgjegjëse për koordinimin e dëgjimeve,
konsultimeve dhe takimeve publike*

Rahovec,
gusht 2021